



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:065965

Datë: 31.01.2019

Numri i dokumentit: 00216596

P.nr. 105/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda- Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. I. ... K. Ferizajit , për shkak të veprës penale, blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në tentativë, nga neni 273 par.1. lidhur me nenin 281 par.1. pika 1.8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR në Pejë PP/L.nr. 107/18 e dt. 07.12.2018, në shqyrtimin e sotëm gjyqësor të mbajtur në prezencën e prokurorit të shtetit Agron Galani, të pandehurit M. I. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Gani Kelmendi, me dt. 31.01.2019 muar dhe botërisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI M. I. i lindur me dt... në Prishtinë ndërsa tani me banim në fsh. ... K. Ferizajit i biri i N. dhe E. e gjinisë S. ka të kryer shkollën e mesme e pa punë, i martuar – baba , i njohur sipas nr. pers., gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës për një vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 03.07.2018, duke qenë në vuajtje të dënimit në SH.K.K-Q..K në Dubravë në mënyrë të paautorizuar me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuan në peshë prej 19 gr. e të cilin narkotik me dt. 03.07.2018, ka tentuar që ta fus në brendi të Q.K. në Dubravë në atë mënyrë që pasi i pandehuri ishte sjellë nga Njësiti i Transportit të Burgosurve nga Gjykata Themelore në Ferizaj ku kishte pas një gjykim si i akuzuar, pas bastisjes dhe kontrollit trupor të pandehurit që i ishte bërë nga ana e oficerëve

korrektues në postën e re (porta 0) nga xhepi i të pandehurit është gjetur dhe sekuestruar narkotike i llojit marihuan në peshë prej 19 gr. .

- me çka ka kryer veprë penale, Blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në tentativë nga neni 273 par.1. lidhur me nenin 281 par.1. pika 1.8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së,

Andaj, gjykata konform nenit 2, 4, par.1. nënpar. 1.1 dhe 1.3, nenit 7,8, 41, 42, par.1. nënpar. 1.1 dhe 1.3, nenit 43 par.1. nënpar.1.2 dhe 1.3, nenit 45 , 46, si dhe nenit 273 par.1. lidhur me nenin 281 par.1. pika 1.8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME BURG

Ashtu që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, e të cilin dënim i pandehuri do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe .

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ia përcakton dënimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej **30 ditësh** nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, e po që se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu llogaritet në shumë prej 20 € .

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, gjykatës të ia paguaj shumën prej **20 € (njëzet euro)** si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej **50 € (pesëdhjetë euro)** e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë të përgjithshme prej 19 gr. konfiskohet dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohet që të shkatrohet.

A r s y e t i m

PTHDKR në Pejë , ndaj të pandehurit M. I. nga fsh. ... K. Ferizajit, ka ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale , blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në tentativë, nga neni 273 par.1. lidhur me nenin 281 par.1. pika 1.8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, me propozim që të caktohet shqyrtimi gjyqësor dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe substanca narkotike e llojit “marihuan” të konfiskohet .

I pandehuri M. I., në shqyrtimin fillestar të dt. 31.01.2019, e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës dhe këtë veprim e ka bërë në baza vullnetare dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij.

Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit, me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, i kanë propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoi si të bazuar.

Gjykata pasi që i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, e vlerësoi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit ishte i vullnetshëm dhe ishte në harmoni të plot me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës si dhe gjykata u bind se i pandehuri i ka kuptuar favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj edhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit e ka aprovuar.

Prokurori i shtetit Agron Galani në fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar se meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë të ia marr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, njëherit i njëjti të shpallet fajtores, të dënohet sipas ligjit, të obligohet në paguarjën e shpenzimeve të procedurës penale si dhe substanca narkotike e llojit marihuan në peshë të përgjithshme 19.gram, të Konfiskohen dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

Mbrojtësi i të pandehurit M. Av. Gani Kelmendi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë që në fazën hershme të procedurës penale, kërkoi nga gjykata që këtë rrethanë ta vlerësoi posaçërisht lehtësuese ngase i mbrojturi im është penduar për veprimet e tij dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris ndonjë veprë penale të tillë .

I pandehuri M.I. në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se në tersi pajtohem e fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi im dhe njëherit më vjen keq për rastin e ndodhur dhe i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të ndodh që unë të kryej ndonjë veprë tjetër penale.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u nisur nga pranimi i fajësisë, ka konstatuar se në veprimet e të pandehurit M.I., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në tentativë nga neni 273 par.1. lidhur me nenin 281 par.1. pika 1.8 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe ka kaluar në shqiptimin e sanksionit penal.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, konform nenit 73 dhe 75 të KPRK-së, për të pandehurin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese , si rrethanë lehtësuese, gjykata mori për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit M., ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë se i pandehuri është edhe më parë i dënuar për veprë penale, dhe për këtë arsye ia shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe i pandehuri do të parandalohet që në të ardhmen të kryej ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata, konform nenit 450 par1. dhe 2. të KPRK-së, të pandehurin e ka obliguar në paguarjën e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, ndërsa konform ligjit nr. 05/L-036, e ka obliguar në paguarjën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata, substancën narkotike, si mjet me të cilin është kryer vepra penale, e ka konfiskuar dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit është urdhëruar që të shkartohej.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda P.nr. 105/18
dt. 31.01.2019**

Sekretarja juridike
Lulavere Mala

Kryetari i trupit gjykues
Sami Sharaxhiu

UDHËZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.